



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

---

Numri i lëndës: 2018:070466

Datë: 17.02.2019

Numri i dokumentit: 00227808

**P.nr.219/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN**, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, më pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër te pandehurit A Z nga fsh.SH K-D, për shkak te veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Peja **PP/II.2362/2018 te dt.10.12.2018**, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 31.01.2019 ne te cilën date është marre dhe publikisht është shpallur aktgjykimi me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të pandehurit, ndërsa me dt. 08.02.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **A Z**, i lindur më dt...., në Istog tani me banim në fsh. SH K- I, i biri i A dhe nënës N e vajzërisë Lodhi, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr...., posedon nr. Tel. ..shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për arsye se:**

Me dt.21.10.2018 rreth orës 21:30 në fsh P K-D, nga pakujdesia ka shkel ligjin pe rregullat e trafikut rrugor nga neni 54 par.1.2, ne atë mënyrë që i pandehuri gjatë qarkullimit me automjetin e tij te llojit ... me targa .....-....., me te arritur në vendin e lartcekur nga mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet atmosferike si dhe mos mbajtja e distancës se sigurisë ,me pjesën e parë ballore godet prapa automjetin e dëshmitares E G ku si pasojë përveç dëmeve materiale lëndime te lehta trupore kanë pësuar edhe te dëmtuarit G dhe M G.

- më çka kishte kryer vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

- Andaj, gjykata në bazë të nenit 7,17, 85, 86 nenit neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, nenit 498, 499 të KPPRK-ës, te pandehurit i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

Më këtë vërejtje gjyqësore të pandehurit i behet me dije se e ka kryer një vepër te dëmshme dhe te rrezikshme qe përbenë vepër penale dhe nëse kryen prapë një vepër te tille, gjykata do te shqiptoj sanksion më të rende penal.

Të dëmtuarit G G dhe M G qe të dy nga fsh.Broliq K-Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Peja më aktakuzë **PP/II.2362/2018 te dt.10.12.2018**, ka akuzuar të pandehurin A Z nga fsh.SH K-D për shkak te veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, ka propozuar të caktohet seanca e shqyrtimit gjyqësorë, të administrohen të gjitha provat e duhura e më në fund i pandehuri të shpallet fajtor dhe te dënohet ne baze te ligjit si dhe te detyrohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne D më **31.01.2019**, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar konform nenit 248 të KPP-ës.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë e ky pranim i fajësisë mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes unë ne tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj , gjykatës i propozoj qe i njëjti te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese te merr pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë shqyrtimit, gjendjen e dobët ekonomike, i pa dënuar më parë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: shpreh keqardhje, jam shumë i penduar, dhe nuk do ta përsëris më këtë vepër.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Më dt.21.10.2018 rreth orës 21:30 në fsh P K-D, nga pakujdesia ka shkel ligjin pe rregullat e trafikut rrugor nga neni 54 par.1.2, ne atë mënyrë që i pandehuri gjatë qarkullimit me automjetin e tij te llojit ... me targa ..., me te arritur në vendin

e lartcekur nga mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet atmosferike si dhe mos mbajtja e distancës së sigurisë, me pjesën e parë ballore godet prapa automjetin e dëshmitares E G, ku si pasojë përveç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore kanë pësuar edhe të dëmtuarit G dhe M G.

Gjykata paraprakisht të pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do të shpallet fajtor për veprën penale të lartë cekur, do të shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të ketë procedurë të provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barre, i cili pranimi fajësie mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 257 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këtë veprë penale, ka vendosur dhe të pandehurin ta shpall fajtor për këtë veprë penale, i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësore, ndërsa e ka obliguar në shpenzimet e procedurës penale.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjellja e mirë e të pandehurit, i pa dënuar më parë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ka vlerësuar se vërejtja gjyqësore e shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në arritjen e qëllimit të dënimit të paraparë me nenin 41 dhe 85 të KPRK-së, si mase për rehabilitimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, ashtu që të pandehurit i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësore.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPRK-së të dëmtuarit G G dhe M G që të dy nga fsh.B K-Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në baze të nenit 453 të KPRK-së gjykata e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale për shkak të gjendjes së dobët ekonomike sepse nëse obligohet në pagesën e shpenzimeve atëherë do të rrezikohet edhe me tej gjendja materiale e të pandehurit ose të personave që ai detyrohet të mbështesë materialisht.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,  
P. nr.219/2018 të dt.08.02.2019**

**Sekretarja juridike  
Sabiha Hoxha**

**G J Y Q T A R I  
Sulltan Dobraj**

**KËSHILLA JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Pejë dega në Deçan.